

Në bazë të nenit 13 paragrafit 2 të Ligjit mbi financimin e subjekteve politike dhe kampanjave zgjedhore ("Fleta Zyrtare e MZ" nr 3/20), Vendimin mbi buxhetin e Komunës së Tuzit për vitin 2020 ("Fleta Zyrtare e MZ" 55/19) U.D. SEKRETARE E Sekretariatit për financime dhe zhvillim ekonomik të Komunës së Tuzit, sjellë:

VENDIM

mbi vlerën e mjeteve buxhetore të destinuar për financimin e punës së rregullt të subjekteve politike për periudhën prej më 01.01.2020 deri më 31.12.2020.

Neni 1

Mjetet Buxhetore për financimin e punës së rregullt të subjekteve politike në kuvendin e komunës janë 1,1% të mjeteve totale buxhetore të planifikuara, të zvogëluara për mjetet e buxhetit kapital (buxheti rrjedhës), për vitin të cilin sillet buxheti i komunës.

Përfundimisht, për komunat buxheti i të cilave është më e vogël se pesë milion euro, mjetet buxhetore për financimin e punës së rregullt të subjekteve politike në kuvendin e komunës është 1,1% prej 3% të mjeteve totale të planifikuara buxhetore, të zvogëluara për mjetet e buxhetit kapital (buxheti rrjedhës), për vitin për të cilin sjellët buxheti i Komunës.

Me Buxhetin e Komunës së Tuzit për financimin e punës së rregullt të partive politike për vitin 2020 janë paraparë mjetet prej 24.272,44 eur gjegjësisht 1,1% të mjeteve totale të planifikuara buxhetore të zvogëluara për mjetet e buxhetit kapital për periudhën prej 01.01.2020. deri 31.12.2020.

Mjetet e destinuar në vlerën prej 20% u shpërndahen në shuma të barabarta subjekteve politike të cilët kanë fituar mandate në Kuvend, gjegjësisht kuvendeve komunale, ndërsa 60% të mjeteve, në përpjesëtim me numrin e përgjithshëm të vendeve parlamentare gjegjësisht mandateve të këshilltarëve që ata mbajnë në kohën e shpërndarjes, përderisa 20% -in tjetër ua shpërndajnë në shuma të barabarta partive politike në Kuvend, gjegjësisht në kuvendet komunale, në përpjesëtim me numrin e përfaqësuesve të zgjedhur me gjininë më të vogël të përfaqësuar.

Neni 2

Mjetet e planifikuara nga neni 1 do tu shpërndahen subjekteve politike të cilët kanë këshilltarë në Kuvendin e Komunës së Tuzit në shumat në vijim:

Partia Demokratike e Socialistëve	7.402,12 €
Alternativa Shqiptare	6.407,63 €
Partia Boshnjake	3.053,32 €
Lidhja Demokratike Shqiptare	3.053,32 €
Unioni Demokratik i Shqiptarëve	2.058,83 €
Socialdemokratët	1.148,61 €
Mali i Zi Demokratik	1.148,61 €
TOTAL	24.272,44 €

Neni 3

Mjetet nga neni 2 u kalohen partive politike çdo muaj, deri me datën pesë të fillim muajit për muajin paraprak.

Neni 4

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e sjelljes, e do të zbatohet për periudhën prej 01.01.2020. deri më 31.12.2020.

